




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Procesverbal i dëgjimeve buxhetore për
përgatitjen e KAB për vitin 2026,
me fokus organizatat joqeveritare, bizneset, fermerët
dhe grupet e interesit që veprojnë në komunën e
Rahovecit.

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore për përgatitjen e Procesverbal i dëgjimeve buxhetore për përgatitjen e KAB për vitin 2026, me fokus organizatat joqeveritare, bizneset, fermerët dhe grupet e interesit që veprojnë në komunën e Rahovecit, u publikua me datë: 13.05.2025 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në këtë vegëz: <https://rahovec.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Njoftim-per-mbajtjen-e-degjimit-publik-per-buxhetin-e-vitit-2026-OJQ.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, si dhe nenit 31 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim nga data: 21.05.2025 deri me datë: 23.05.2025 do të organizohen trembëdhjetë (5) dëgjime publike buxhetore.

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendari i dëgjimeve buxhetore për pesë (5) dëgjimet buxhetore në komunën e Rahovecit në këtë vegëz: <https://rahovec.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Kalendari-i-degjimeve-publike-buxhetore-per-pergatitjen-e-KAB.pdf> më datë: 07.05.2025.

Po ashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar *kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane*, ku janë të informuar rreth mbajtjes së dëgjimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilin vendbanim, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit.

Njoftimi për mbajtjen e dëgjimit buxhetor *me fokus punonjësit e shërbimeve publike dhe punëtorët shëndetësorë*, u publikua më datë 13.05.2025 në këtë vegëz:

<https://rahovec.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Njoftim-per-mbajtjen-e-degjimit-publik-per-buxhetin-e-vitit-2026-OJQ.pdf>

Njoftimet përveç që janë publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber dhe WhatsApp.

DËGJIMI PUBLIK ME FOKUS ORGANIZATAT JOQEVERITARE, BIZNESET, FERMERËT DHE GRUPET E INTERESIT

Dëgjimi buxhetor me fokus organizatat joqeveritare, bizneset, fermerët dhe grupet e interesit që veprojnë në komunën e Rahovecit: 21.05.2025 në Sallën e Kuvendit Komunal, në orën 13:30.

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 38

- Femra ishin: 8
- Meshkuj ishin: 30

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë dëgjim.

Blerta Nalli Gashi: Të nderuar të pranishëm përshëndetje! I nderuar kryetar, i nderuar drejtor për Buxhet dhe Financa, drejtorë të drejtorive, anëtarë të grupit punues për përgatitjen e buxhetit, të nderuar të pranishëm! Mirë se erdhët në dëgjimin e dytë buxhetor në ciklin 3-ditor të dëgjimeve buxhetore për përgatitjen e KAB-it komunal, për të vazhduar në korrik e gusht me dëgjimet tjera buxhetore për përgatitjen e buxhetit komunal për vitin 2026. Procesi i buxhetimit në nivelin lokal i referohet procedurave dhe përgjegjësive të institucioneve të përfshira në procesin e miratimit, ekzekutimit dhe raportimit të buxheteve komunale. Procesi i buxhetimit duhet të jetë i qartë sepse rrit përgjegjësinë dhe llogaridhënien para publikut për ata që janë të përfshirë në zhvillimin e buxhetit. Një proces efektiv dhe efikas i buxhetimit në nivelin lokal do të rezultojë në cilësinë e dokumenteve të buxhetit, miratimin në kohë të dokumenteve buxhetore dhe funksionimin e duhur të institucioneve komunale. Në kthim, kjo do të rezultojë në ofrimin e mirë të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset. Fillimisht ia kaloj fjalën drejtorit të drejtorisë për buxhet dhe financa për një prezantim të shkurtër të buxhetit nga Qarkorja e parë buxhetore e cila ka arritur më 16 maj, më pas ju mund t'i parashtroni kërkesat tuaja, të cilat do të evidentohen në procesverbale.

Afrim Limani: Faleminderit! Atëherë këto janë dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2026, si dhe në tabelar i keni edhe projeksionet 2027, 2028. Në cilësi të drejtorit për buxhet dhe financa po ju prezantoj qarkoren e parë buxhetore 2026. Në këtë qarkore janë limitet dhe tavanet buxhetore. Sipas kësaj qarkore, buxheti është 21.547.000€. Buxheti i administratës është 9.168.000€, buxheti për arsim 7.3 milionë, buxheti për shëndetësi 2.4 milionë, të hyrat vetanake 80.000. Duke pasur për bazë grantin e përgjithshëm, bashkë me ty hyrat vetanake e në pozicion të pagave e kemi këtë buxhet: 12.445.000€. Mallrat dhe shërbimet janë të njëjta në krahasim me vitin e kaluar, të njëjta janë edhe shpenzimet komunale. Investimet kapitale fatkeqësisht do të pësojnë rënie, në 4.941.000, 1.3 milionë më pak në vitin e kaluar. Në vitin 2026 do të përballemi me dy sfida: Zvogëlimit të numrit të nxënësve në arsim dhe zvogëlimit të numrit të popullsisë së komunës së Rahovecit. Kjo gjendje ka reflektuar drejtpërdrejt në buxhet. Granti i përgjithshëm i administratës duhet të jetë mbulesë e mungesës së buxhetit në pozicion të

pagave, rreth 1.700.000€. Ky pozicion shkon në dëm të investimeve kapitale, sepse është e paraparë që investimet kapitale do të zvogëlohen.

Kryetari: Faleminderit drejtor! Të nderuar pjesëmarrës, organizata joqeveritare, biznese, fermerë! Jemi në ciklin e parë të dëgjimeve buxhetor - tendencë për planifikim të hershëm të buxhetit. Drejtori e shpjegoi qarkoren e parë buxhetore, përkatësisht kornizën afatmesme të shpenzimeve, 2026-2028. Njëra prej sfidave është regjistrimi i popullsisë dhe ndërkohë që ligji aktual mbi menaxhimin e financave nuk ka pësuar plotësim-ndryshim. Ligji është i vjetër, që do të thotë që rezultatet e regjistrimit të popullsisë na ka paralizuar, sepse kemi zvogëlim të numrit të popullsisë që ndikon direkt në kufizimet buxhetore. Sfida tjetër është ndëshkimi më i madh për ne - kontrata kolektive. Zakonisht, përveç Prishtinës dhe Prizrenit, pasojat në komunën tonë janë enorme, thesari na ka marrë 1.6 milionë, pothuajse në të gjitha kategoritë buxhetore. 1.8 milionë i kemi tjera dhe në bazë të trendit të lëndëve që na vinë, ata janë të gatshëm të na marrin edhe këto. Këto dy sfida janë më të mëdha dhe duhet të kemi akomodim me të madh me prioritete, njëkohësisht ta ruajmë një stabilitet financiar. Ne do ta bëjmë një punë të madhe me aq sa kemi kompetencë dhe do të komunikojmë dendur që qarkorja e dytë buxhetore mos të jetë si kjo e para. Betejë e re që do të zhvillohet me Ministrinë e Financave. Duhet t'i shtyjmë disa tema që ta përballojmë sa ma shumë buxhetin dhe nevojat që i ka komuna e Rahovecit. Thuhet që ka buxhet të përshtatur që ta zbusin negativitetin për shkak të regjistrimit të popullsisë. Dua të dal edhe te një temë tjetër, meqenëse jemi e ojq-të, bizneset dhe fermerët. Ne, është vështirë të themi që do t'i zvogëlojmë subvencionet. Nëse këtë vit i kemi 1.100.000€ vitin tjetër duhet të tentojnë t'i kemi 1.110.000€. Do të kemi sfida, por subvencionet nuk do t'i ulim. Te investimet kapitale është mbi 1 milion më pak, por do të përpiqemi që të jetë së paku 500.000 më pak. Gjithashtu, kërkesat për mallra dhe shërbime parashihen të rriten, ani pse po zvogëlohet numri i banorëve, por kërkesa për mirëqenie do të rritet. Kontrata kolektive po na godet posaçërisht në këto kode buxhetore dhe si komunë është duke na penalizuar. Gjithashtu, duhet të sigurohemi që programet që ndihmohen nga komuna duhet të jenë më serioze dhe të përpiqemi që ojq-të fiktive mos t'i ndihmojmë, sepse ka prej tyre që kanë fiktivitet. Pra, duhet të jemi më seriozë në aplikime, prandaj ftesa jonë është që të jemi më të artikuluar që projektet të zbatohen më me plotni. 21.547.000€ është buxheti total për 2025. Një nga shpresat tona për stabilitet, është edhe angazhimi maksimal në mbledhjen e tatimit në pronë. Përkundër këtyre sfidave që i kemi, do t'i ndihmojmë ojq-të maksimalisht, sikurse do të provojmë deri në qarkoren e dytë ta bëjmë një betejë që t'i zbusim këto sfida që i kemi dhe mund t'i kemi tutje.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit Blertë! Përshëndetje për të gjithë! Meqenëse jam anëtar i kuvendit, sot po flas si fermer. Duke e përcjellur buxhetin dhe KAB-in, më duket një buxhet më i ngulfatur me vitet paraprake. Te pagat dhe mëditjet kemi ndryshim të madh, rritje 15%, pse ky ndryshim kaq i madh? Diferenca për brenda një viti më duket që nuk është në përputhje. Drejtori e tha më herët që jemi në sfidë për shkak të numrit të popullsisë, por, në total kemi rritje të buxhetit dhe ndryshime në kategoritë buxhetore, ulje dhe ngritje drastike. Te subvencionet, besoj që nuk do të ketë problem. Besoj gjithashtu që komuna do t'i qëndron afër ciklit buxhetor deri te qarkorja e dytë buxhetore dhe të gjejë një zgjidhje që mos të penalizohet më tutje, sepse sipas kësaj gjendje ky vit do të jetë sfidues, por nëse shkojmë kështu, mund të bëhet edhe më vështirë.

Afrim Limani: Defrim, gjatë prezentimit i potencova efektet negative. Paga në 2025 janë 10.446.000. Rritja e buxhetit në 1300 punëtorë e bën her 110 dhe e sheh rezultatin dhe përqindjen e sakt. Numri i zvogëlimit të nxënësve në arsim dhe numri i zvogëlimit të banorëve, ka ndikuar në zvogëlimin e buxhetit të arsimit dhe shëndetësisë. Fatbardhësisht na kanë aprovuar numrin e sftatit ekzistues në shëndetësi. 1.8 milionë e kemi buxhetin më pak si rezultat i këtyre dy faktorëve. Jemi me fat që punëtorët i kanë aprovuar, por këtë diferencë negative ne duhet ta paguajmë përmes grantit të shpenzimeve.

Kryetari: Defrimi i ka ngritur disa tema. Besoj që stabiliteti financiar i komunës nuk është pa anomali, por nuk e lejon bankruptin - falimentimin. Shorti më ka ra që të jem anëtarë i komisionit të granteve dhe këtu formulën e kemi nga ligji i vjetër dhe regjistrimi i popullsisë është i ri. Duhet të bëjmë manovra dhe betejë që të nxjerrim produkte të reja që nuk janë në qarkoren e parë. Mund të kemi situata pozitive dhe në vitin e parë të ketë situata që trajtohen më shpejt. Rritja e pagave ka krijuar disproporcion me kategoritë tjera buxhetore, 57% e buxhetit total të Rahovecit janë vetëm paga. Kjo nuk është mesazh për zhvillim. Dëfrimi ka të drejtë të kërkojë rrugë më të pastër, mirëmbajtje të hapësirave publike dhe të gjitha këto janë kategori e mallrave dhe shërbimeve, sepse kërkesa për mirëqenie është e vazhdueshme dhe kjo kategori buxhetore duhet të ketë rritje. Sfidën më të madhe e kemi që kur të dalin në pension mësimdhënësit, duhet të shpallim konkurs vetëm nëse është nevojë e madhe, sepse në këtë mënyrë reduktohet numri i mësimdhënësve. Konkursi shpallet vetëm kur ka deficit të kuadrove. Mjafton që këta që i kemi mos t'i heqim nga puna dhe t'ju plotësojmë normat në plotni. Konkursët duhet të jenë më të rralla. Duhet të jemi më të vëmendshëm, krejt kjo nëse nuk ndërron qarkorja e dytë buxhetore dhe kjo gjendje e krijuar. Pra, numri i nxënësve është duke u zvogëluar dhe numri i mësimdhënësve është ai që ka qenë. Sfidë kemi nga Ministria e Financave të Republikës së Kosovës, por mendoj që do t'i kalojmë.

Hamëz Rama: Shoqata Enologjia: Përshëndetje për të gjithë, prezentimi ishte konciz dhe sfidues, sepse kanë interferuar shumë elemente. Direkt regjistrimi i popullsisë në raport me gjendjen aktuale që është krijuar dhe ka ndikuar në uljen e shpenzimeve të kodeve buxhetore, në shpenzime kapitale dhe në uljen e gjenerimit të vendeve të punës, si dhe direkt në shpenzimet për shëndetësi dhe arsim. Kryetari na siguroi që subvencionet nuk do të zvogëlohen. Mund të them që gjendja reale ka ndikuar në mungesë të formimit të institucioneve dhe ne si komunë jemi goditur shumë, sepse është sfidë e madhe për tutje. Besoj që do t'ia dalim, por duhet të kemi vëmendje në nivelin e jetës së qytetarëve dhe jetës së bizneseve që në mënyrë të padiskutueshme po iu rritet kostoja e prodhimit. Çështja tjetër është që kërkohet është që të ketë rritje në pozicionin e mallrave dhe shërbimeve, sepse mirëmbajtja kërkohet çdo ditë. Shoqata jonë funksionon në bazë të ligjeve në fuqi dhe po mundohemi në vazhdimësi ta luajmë rolin dhe të kemi bashkëpunime të mira me komunën, të cilën e falënderojmë. Kemi edhe kërkesa tjera, por tani po e shohim që jemi në një situatë të vështirë financiare. Si shoqatë i kemi disa kërkesa në interes komunal, por do t'i paraqesim në formë të shkruara, në drejtoritë përkatëse.

Defrim Kafexhiu: Kërkesë specifike: Komuna duhet ta krijojë një alternativë buxhetore për shpronësimet ku komuna nuk ka pronë publike. Për moment i kemi dy raste specifike. Kërkoj që të ndahet një buxhet për shpronësimin e pronave private. Lagjja te rruga "Vëllezërit Frashëri" dhe lagjja e epërme që të kenë parcela për vendosjen e trafos, sepse departamenti i

vlerësimet po i bën qytetarët të pakënaqur me vlerën që po ju jep parcelave të tyre. Meqenëse jemi në qarkoren e parë buxhetore, po e bëj këtë propozim.

Kryetari: Faleminderit Hamëz! Defrim, të inkurajoj të aplikoni me një program me të gjitha ato që i the, përkundër këtyre situatave të qarta që i kemi. Kushtimisht po them, shteti po na bën hile me kontratat kolektive, ne ia kemi bërë me kontratat me ojq-të, që tanimë i kanë marrë tani gjysmën e subvencioneve. Defrim, jemi 24 orë aktivë. Shpresojmë të punojmë me KEDS-in dhe shumë shpejt ta zgjidhim këtë çështje të trafos te lagjja "Vëllezërit Frashëri".

Shkumbim Arifi: (SHL Kosova): Faleminderit! Përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë! Te subvencionet gati nuk jemi prekur hiç. E kam një lutje të vogël, nëse mund të kemi debat se si t'i shpenzojmë këto para të subvencioneve. Besoj që do të ishte e mirë si temë për diskutim.

Kryetari: Ne do ta kemi ciklin e dëgjimeve buxhetore, në korrik dhe gusht. Në fillim të qershorit e kemi buxhetimin gjinor, do të kemi grupe specifike të interesit dhe finalja do të jetë përpjekja për certifikim të buxhetit në Ministri të Financave. Deri atëherë, shpresojmë që të kemi situata më të favorshme dhe situata se si t'i zbatojmë programet tona. Është mirë që subvencionimi të ketë më shumë siguri dhe efektivitet.

Selman Shtavica: Përshëndetje! Hendikosi oshtë ojq, kemi sfida të mëdha në të gjitha aspektet. Me persona me aftësi të kufizuara dhe me pleq. Kemi nevojë për një depo për karroca dhe kemi kërkesa mjaft për karroca dhe pako higjienike. Ta gjejmë një mënyrë që t'ju ndalim në ndihmë kësaj kategorie të njerëzve.

Kryetari: Parafytyroni si ka qenë Hendikosi para 6 muajve dhe shikoni siç është tani. Janë investuar 300.000€ aty. Sa i përket aneksit apo depos shtesë, aty shumë zyra që janë të zbrazëta. Zgjeroheni stafin, sepse me njerëz me aftësi të veçanta nuk punoni veç ju, punon edhe Hareja dhe SHL Kosova. Mos kërkonit diçka që është e tepërt dhe ju lutem që të bëheni më të arsyeshëm.

Ali Hoxha: (Shoqata e afaristve -Rahovec): E përshëndes kryetarin me stafin e tij. Kërkesë që për cdo debat që ka komuna të na informimi, sepse ne kemi dëshirë të jemi më aktivë.

Blerta Nalli Gashi: A ka edhe dikush tjetër ndonjë pyetje? Nëse jo, atëherë këtu përfundon takimi i sotëm. Ju falënderoj për kontributin.



Albion Krasniqi

Procesmbajtës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



1. Lista e nënshkrimeve nga dëgjimet publike buxhetore me organizatat joqeveritare, bizneset, fermerë dhe grupet e interesit që veprojnë në komunën e Rahovecit, për KAB-in 2026-2028

| Nr | Emri | Mbiemri | Vendi | Nr. telefonit | Nënshkrimi |
|-----|---------|------------|-----------|---------------|------------|
| 1. | QENORIM | THAQI | XËRXE | | |
| 2. | FATMIR | SEJFULLAHU | KR. MADHE | | |
| 3. | QEMAJL | BEASNIQI | RAHOVEC | | |
| 4. | FERIZ | THAQI | RAHOVEC | | |
| 5. | Shelqet | Morina | Rahovec | | |
| 6. | Xhafer | BYTYQI | Xerxe | | |
| 7. | Emir | Kollari | Rahovec | | |
| 8. | Meriton | Goshi | Rahovec | | |
| 9. | | | | | |
| 10. | | | | | |
| 11. | | | | | |
| 12. | | | | | |
| 13. | | | | | |
| 14. | | | | | |
| 15. | | | | | |
| 16. | | | | | |
| 17. | | | | | |
| 18. | | | | | |
| 19. | | | | | |
| 20. | | | | | |

Vërejtje: Me nënshkrimin tim në listën e komunës, unë, konfirmoj se komuna mund të përdorë kontaktet e ofruara nga ana ime për të më dërguar njoftime periodike për ngjarje të cilat janë në interes publik. Me nënshkrimin tim, konfirmoj se autoritetet e komunës mund të regjistrojnë takimin për qëllime të procesverbalit dhe të publikimit të fotografive dhe video materialeve promovuese nga këto takime.

Më 21.5.2025, Në sallën e Kuvendit Komunal të Rahovecit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



1. Lista e nënshkrimeve nga dëgjimet publike buxhetore me organizatat joqeveritare, bizneset, fermerë dhe grupet e interesit që veprojnë në komunën e Rahovecit, për KAB-in 2026-2028

| Nr | Emri | Mbiemri | Vendi | Nr. telefonit | Nënshkrimi |
|-----|----------|-----------|----------|---------------|------------|
| 1. | ALI | HOXHA | RAHOVE | | |
| 2. | EMIRE | DURAKU | K. MADHE | | |
| 3. | Alfred | Cena | Rahovec | | |
| 4. | Altin | Selmanena | Rahovec | | |
| 5. | Burim | Dula | Rahovec | | |
| 6. | Lahuta | Dula | Rahovec | | |
| 7. | SHKURBAN | ARIFI | SHK | | |
| 8. | Selman | SHKURBAN | HRELKOS | | |
| 9. | Naser | Dula | Rahovec | | |
| 10. | Detrim | Kollexhiu | Rahovec | | |
| 11. | | | | | |
| 12. | | | | | |
| 13. | | | | | |
| 14. | | | | | |
| 15. | | | | | |
| 16. | | | | | |
| 17. | | | | | |
| 18. | | | | | |
| 19. | | | | | |
| 20. | | | | | |

Vërejtje: Me nënshkrimin tim në listën e komunës, unë, konfirmoj se komuna mund të përdorë kontaktet e ofruara nga ana ime për të më dërguar njoftime periodike për ngjarje të cilat janë në interes publik. Me nënshkrimin tim, konfirmoj se autoritetet e komunës mund të regjistrojnë takimin për qëllime të procesverbalit dhe të publikimit të fotografive dhe video materialeve promovuese nga këto takime.

Më 21.5.2025, Në sallën e Kuvendit Komunal të Rahovecit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



1. Lista e nënshkrimeve nga dëgjimet publike buxhetore me organizatat joqeveritare, bizneset, fermerë dhe grupet e interesit që veprojnë në komunën e Rahovecit, për KAB-in 2026-2028

| Nr | Emri | Mbiemri | Vendi | Nr. telefonit | Nënshkrimi |
|-----|------------|-------------|--------------------|---------------|---------------------|
| 1. | FATOS | HANK | RAHOVEC | | |
| 2. | Indrit | Krasniqi | Rahovec | | |
| 3. | ISMET | HAXHIMURATI | RAHOVEC | | Amante (BIOPAK.SHE) |
| 4. | Hamëz | Pama | Rahovec | | SHKUR EXHIBICIA |
| 5. | Adelina | Vçitërna | Rahovec | | Agjelia |
| 6. | Samra | Kërgagu | Rahovec | | Shkup. |
| 7. | Resceurico | Fatçiqi | Rahovec | | Resceurico |
| 8. | Sead | Kaloz | osec | | Sead |
| 9. | ADMIR | KADRIU | RAHOVEC | | |
| 10. | | | | | |
| 11. | | | | | |
| 12. | | | | | |
| 13. | | | | | |
| 14. | | | | | |
| 15. | | | | | |
| 16. | | | | | |
| 17. | | | | | |
| 18. | | | | | |
| 19. | | | | | |
| 20. | | | | | |

Vërejtje: Me nënshkrimin tim në listën e komunës, unë, konfirmoj se komuna mund të përdorë kontaktet e ofruara nga ana ime për të më dërguar njoftime periodike për ngjarje të cilat janë në interes publik. Me nënshkrimin tim, konfirmoj se autoritetet e komunës mund të regjistrojnë takimin për qëllime të procesverbalit dhe të publikimit të fotografive dhe video materialeve promovuese nga këto takime.

Më 21.5.2025, Në sallën e Kuvendit Komunal të Rahovecit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Lista e nënshkrimeve të zyrtarëve pjesëmarrës nga Dëgjimet Buxhetore publike për KAB-in
2026-2028

| Nr | Emri | Mbiemri | Pozita | Nr. telefonit | Nënshkrimi |
|-----|----------|----------------|--------------------|---------------|------------|
| 1. | AGNESA | RAMADANI | Z. TAJESA AFARIK | | |
| 2. | ARDIT | HALILAJ | SHET I KABINETIT | | |
| 3. | AUNI | MORINA | Drejtori DKA | | |
| 4. | EREM | BYTYCI | Z. K. F | | |
| 5. | Andriam | Ramu | Z. Financion | | |
| 6. | Skender | Herriza | Udh. Sektori | | |
| 7. | Albion | Kresimiqi | Z. Kuvendit | | |
| 8. | Dendiesu | Ligjetiu Horcu | Buxhet dhe financa | | |
| 9. | IZET | MORINA | Buxhet dhe Financa | | |
| 10. | Bleda | Gashi | Informim | | |
| 11. | ALBAN | GASHI | Z. B. GJ | | |
| 12. | | | | | |
| 13. | | | | | |
| 14. | | | | | |
| 15. | | | | | |
| 16. | | | | | |
| 17. | | | | | |
| 18. | | | | | |
| 19. | | | | | |
| 20. | | | | | |

Vërejtje: Me nënshkrimin tim në listën e komunës, unë, konfirmoj se komuna mund të përdorë kontaktet e ofruara nga ana ime për të më dërguar njoftime periodike për ngjarje të cilat janë në interes publik. Me nënshkrimin tim, konfirmoj se autoritetet e komunës mund të regjistrojnë takimin për qëllime të procesverbalit dhe të publikimit të fotografive dhe video materialeve promovuese nga këto takime.

Më 21.5.2025, Në sallën e Kuvendit Komunal të Rahovecit